

**MESSER ALBAGAZ Sh.p.k.**

Raporti i audituesit të pavarur dhe  
pasqyrat financiare për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

## Përmbajtja

	<u>Page</u>
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i-ii
PASQYRAT FINANCIARE:	
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020	1
Pasqyra e fitim humbjes dhe te ardhurave gjithheperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	3
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	4
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 25

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarit dhe Drejtimit të Messer Albagaz sh.p.k.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Messer Albagaz sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Informacione të tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në Raportin vjetor të Shoqërisë, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti vjetor i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose, nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuar me qeverisjen.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

**Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevantë për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Drejtimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshëm, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA SHPK

BDO Albania sh.p.k.

31 mars 2021

Tiranë, Shqipëri

**BDO**  
BDO ALBANIA sh.p.k.  
NIPT L02407004C  
TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda  
Partner Angazhimi

**Messer Albagaz Sh.p.k.**  
 Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor  
 (Shumat në mijë Lek)


	Shënime	2020	2019
<b>Aktivet</b>			
Aktive afatgjata te trupezuara	5	406,407	417,928
Aktive afatgjata te patrupezuara	6	8,011	8,223
Rental Aset IFRS 16	5	3,108	2,866
<b>Aktivet afatgjata</b>		<b>417,526</b>	<b>429,017</b>
Inventaret	7	20,526	23,590
Te arketueshme tregtare dhe te tjera	8	104,402	95,720
Tatim fitimi i parapaguar		1,405	4,353
Parapagime dhe aktive te tjera	9	-9,565	5,946
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10	41,116	17,920
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		<b>157,884</b>	<b>147,529</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>575,410</b>	<b>576,546</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	11	706,772	706,772
Rezerva	11	6,208	6,208
Humbje te mbartura		(300,334)	(298,930)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>412,646</b>	<b>414,050</b>
<b>Detyrimet</b>			
Lease Liabilities IFRS 16		3,212	2,513
Detyrimet e shtyra tatimore	18	5,299	5509
<b>Detyrimet afatgjata</b>		<b>8,511</b>	<b>8,022</b>
Te pagueshme tregtare dhe te tjera	12	146,901	147,142
Parapagime te marra	13	7,352	7,332
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>154,253</b>	<b>154,474</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>162,764</b>	<b>162,496</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>575,410</b>	<b>576,546</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiarene faqet 5 deri 25.

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga aksionari i vetem i Shoqerise me 29 mars 2021 dhe jane nenshkruar ne emer te tij nga:

  
 Vladimir Vladimirov  
 Administratori



  
 Migel Zallëmi  
 Pergatitesi

Messer Albagaz Sh.p.k.  
 Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor  
 (Shumat në mijë Lek)

	Shenime	2020	2019
Shitje		390,968	350,883
Kosto e shitjeve		(318,269)	(290,330)
<b>Fitimi bruto</b>	14	<b>72,699</b>	<b>60,553</b>
Te ardhura te tjera	15	26,935	17,830
Shpenzime te shitjes dhe shperndarjes	16	(68,838)	(61,124)
Shpenzime administrative	17	(27,492)	(24,278)
<b>Rezultati nga veprimtaria operative</b>		<b>3,304</b>	<b>(7,019)</b>
Te ardhura financiare neto		(1,252)	964
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>2,052</b>	<b>(6,055)</b>
Perfitimi i tatimit mbi fitimin	18	(3,456)	954
<b>Humbja e vitit</b>		<b>(1,404)</b>	<b>(5,101)</b>
Humbje te tjera gjithepershiresë, neto nga tatim fitimi		-	-
<b>Totali i humbjes gjithepershiresë te vitit</b>		<b>(1,404)</b>	<b>(5,101)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershiresë duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiarene faqet 5 deri 25.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Shumat në mijë Lek)

	Kapitali i Regjistruar	Rezerva	Humbje te akumuluar	Totali
<b>Gjendja me 1 janar 2019</b>	<b>706,772</b>	<b>6,208</b>	<b>(293,829)</b>	<b>419,151</b>
Transaksionet me pronaret qe regjistrohen direkt ne kapital				
Humbje totale gjithperفشirese per vitin				
Humbje per vitin	-	-	(5,101)	(5,101)
Humbje te tjera gjithepershirese, neto nga tatimi	-	-	-	-
Humbje totale gjithperفشirese per vitin	-	-	(5,101)	(5,101)
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2019</b>	<b>706,772</b>	<b>6,208</b>	<b>(298,930)</b>	<b>414,050</b>
Transaksionet me pronaret qe regjistrohen direkt ne kapital				
Humbje totale gjithperفشirese per vitin				
Humbje per vitin			(1,404)	(1,404)
Humbje te tjera gjithepershirese, neto nga tatimi				
Humbje totale gjithperفشirese per vitin			(1,404)	(1,404)
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2020</b>	<b>706,772</b>	<b>6,208</b>	<b>(300,334)</b>	<b>412,646</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare ne faqet 5 deri ne 25.

**Messer Albagaz Sh.p.k.**Pasqyra e flukseve të parasëpër vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(Shumat në mijë Lek)

Shenime	2020	2019
<b>Flukse monetare nga aktivitetet operative</b>		
Humbja para tatimit	2,052	(6,055)
<i>Rregullimet per:</i>		
Amortizimin	21,174	22,609
Fitiminnga shitja e aktiveve te trupezuara	1,734	51
Shpenzimin per humbjenga zhvleresimi i te arketueshmeve tregtare	(11,950)	7,405
	<u>13,010</u>	<u>24,009</u>
<i>Ndryshimet ne:</i>		
- inventare	3,064	12,946
- llogarite e arketueshme	3,268	(9,902)
- aktive te tjera	15,269	(1,448)
- te pagueshme tregtare dhe te tjera	(241)	(19,194)
- detyrime te tjera	719	2,821
	-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar	2,948	-
<b>Flukse neto nga aktivitetet operative</b>	<u>38,037</u>	<u>9,213</u>
<b>Flukse monetare nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata te trupezuara	(13,133)	(8,524)
Arketime nga shitja e aktiveve te trupezuara	1,958	586
<b>Flukse neto te perdorura ne aktivitetet investuese</b>	<u>(11,175)</u>	<u>(7,575)</u>
<b>Renie neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare</b>	23,196	1,294
Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj ne fillim te vitit	17,920	16,626
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj ne 31 dhjetor</b>	<u>41,116</u>	<u>17,920</u>

Pasqyra e flukseve te paraseduhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare ne faqet 5 deri ne 25.



## 1. Hyrja

### a) Informacion i përgjithshëm

Messer Albagaz Sh.p.k. ("Shoqeria") është një shoqëri e vendosur në Tiranë. Shoqëria është e përfshirë në prodhimin, shitjen, dhe shpërndarjen e gazrave teknike, mjekësore dhe të veçanta, si dhe shitjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit. Shoqëria është regjistruar në vitin 2007 dhe në 2011 u ble nga Messer Tehnogas AD, një shoqëri e vendosur në Serbi. Messer Tehnogas është pronari i vetëm i Shoqërisë.

Me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Shoqëria ka operuar nga magazinat në Tiranë, Gjirokastër, Korçë dhe Elbasan.

### b) Vlerësimi i Drejtimitmbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimitesë

Shoqëria realizoi humbje neto prej 1,404 mijë Leke (2019: 5,101 mijë Leke) dhe me 31 dhjetor 2020 ka humbje të akumuluar prej 300,334 mijë Leke (2019: 298,930 mijë Lek). Kjo është kryesisht për shkak të kohës së nevojshme për zhvillimin e biznesit pas ndryshimit të pronësisë me 2011, për shkak të vonësive në marrjen e disa licensave të prodhimit dhe tregtimit, si dhe për shkak të konkurrencës vendase. Shoqëria mbështetet vazhdimisht nga kontributet e pronarit, i cili është gjithashtu edhe furnitori kryesor.

Shoqëria pret që të ardhurat të rriten në vitet në vijim dhe kostot e shitjeve të zvogelohen si rezultat i një licënce të re tregtare që ka marrë në gjysmën e parë të vitit 2019, e cila do t'i mundësojë Shoqërisë të rrisë të ardhurat nëpërmjet qasjes në kliente të rinj dhe të zvogelojë kostot e pagueshme ndaj paleve të treta. Si rezultat, Shoqëria pret të përmirësojë marzhin brutë të fitimit dhe të realizojë fitim në vitet në vijim. Edhe pse detyrimet afatshkurtra tejkalojnë aktivet afatshkurtra, këto detyrime janë ndaj paleve të lidhura (shih shënimin 12). Drejtimi synon të shfrytëzojë kushtet e kreditimit tregtar të ofruara nga palet e lidhura dhe të vazhdojë të ketë qasje në financimin prej tyre.

Bazuar në angazhimin e Shoqërisë me për të vazhduar mbështetjen ndaj Shoqërisë dhe performancës financiare të parashikuara, këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimitesë, që supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, sipas afatëve përkatëse në të ardhmen e pritshme.

## 2. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, të cilat u bënë të detyrueshme në Shqipëri në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave Nr. 65, dt. 05.05.2008, "Për publikimin dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe".

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njëra tjetres dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjeshme e zbatueshme për të netuar shumën e njohura dhe ka qëllim shlyerjen e tyre mbi bazë neto, ose të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sic parashikohet në mënyrë specifike në politikën kontabel të Shoqërisë.

## 2 Bazat e Pergatitjes se Pasqyrave (vazhdim)

### 2.1 Zbatimi i standardeve nderkombetare te reja dhe te rishikuara te raportimit financiar

#### 2.1.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabel te adoptuara jane konsistente me politikat e vitit te meparshem me perjashtim te SNRF-ve te ndryshuara, te cilat jane adoptuar nga Shoqeria ne daten 1 janar 2020:

- Ndryshimet ne SNRF 3: Perkufizimi i biznesit
- Ndryshimet ne SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Normes se Interesit Referuese
- Ndryshimet ne SNK 1 dhe SNK 8: Perkufizimi i materialitetit
- Kuadri Konceptual ne Standartet e SNRF-se
- Ndryshimet ne SNRF 16 Lidhur me lehtesira e lidhura me qerane si pasoje e Covid 19

Megjithese keto standarde dhe ndryshime te reja jane aplikuar per here te pare duke filluar nga 1 janar 2020, ato nuk kane patur impakt material, ne pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise Natyra dhe ndikimi i cdo standardi dhe ndryshimi eshte pershkruar si vijon:

#### - Ndryshimet ne SNRF 3: Perkufizimi i biznesit

Ne tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet ne perkufizimin e biznesit ne SNRF 3 Kombinimet e biznesit per te ndihmuar njesite te percaktojne nese nje set aktivesh te pervesuara perben nje biznes ose jo. Aty sqarohet minimumi i kerkesave per nje biznes, hiqet vleresimi nese nje pjesetar i tregut eshte ne gjendje te zevendesoje ndonje element qe mungon, dhe shtohen udhezimet per te ndihmuar njesite te vleresojne nese nje proces i pervesuar eshte thelbesor, ngushton perkufizimet e biznesit dhe rezultateve, dhe prezanton nje test opsional te perqendrimin te vleres se drejte. Shembuj te rinj ilustrues jane prezantuar bashke me ndryshimet. Ndryshimet jane efektive per kombinimet e biznesit per te cilat data e blerjes eshte ne periudhen e pare vjetore te raportimit qe fillon ne ose pas 1 janarit 2020 dhe per blerjet e asetave qe ndodhin ne ose pas fillimit te asaj periudhe, aplikimi i me hershem eshte i lejueshem. Ky ndryshim nuk ka efekt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

#### - Ndryshimet ne SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Normes se Interesit Referuese

Ndryshimet ne SNRF 9 dhe SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja sigurojne nje numer lehtesimesh, te cilat zbatohen per te gjitha marrdheniet mbrojtese (hedging relationship) qe ndikohen drejtperdrejt nga reforma e normes se interesit referueses. Nje marredhenie mbrojtese ndikohet nese reforma krijon pasiguri ne lidhje me kohen dhe / ose shumen e flukseve te reformuar te parase te artikullit mbrojtës ose instrumentit mbrojtës. Ka gjithashtu ndryshime ne SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shenimet shpjeguese ne lidhje me informacionet shpjeguese shtese rreth pasigurise qe vijne nga reforma e normes se interesit referues. Ndryshimet jane efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2020 dhe duhet te zbatohen ne menyre retrospektive. Keto ndryshime nuk kane asnje ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise pasi ajo nuk ka ndonje marredhenie mbrojtese (hedging relationship) te normes se interesit.

#### - Ndryshimet ne SNK 1 dhe SNK 8: Perkufizimi i materialitetit

Ne tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet e SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare dhe SNK 8 Politikat kontabel, ndryshimet ne vleresimet kontabel dhe gabimet per te perafuar perkufizimin e 'materialitetit' ndermjet standardeve dhe per te sqaruar disa aspekte te perkufizimit. Perkufizimi i ri shprehet se 'informacioni eshte material nese perjashtimi, deklarimi i gabuar ose fshehja e tij mund te ndikojne ne menyre te aresyeshme vendimet qe perdoruesit kryesore te pasqyrave financiare te pergjithshme marrin bazuar ne ato pasqyra financiare, te cilat japin informacion mbi nje njesi specifike. Ndryshimet jane efektive per periudha vjetore te raportimit qe fillon ne ose pas 1 janarit 2020, aplikimi me hershem eshte i lejueshem. Ky ndryshim nuk ka efekt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

## 2. Bazat e Pergatitjes se Pasqyrave (vazhdim)

### 2.1.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

#### - Kuadri Konceptual ne Standartet e SNRF-se

BSNK publikoi Kuadrin Konceptual te rishikuar per raportimin financiar me 29 mars 2018. Kuadri Konceptual percakton nje seri gjithepershires te koncepteve per raportimin financiar, vendosjen e standardeve, udhezim per hartuesit ne zhvillimin e politikave te qendrueshme kontabel dhe ndihmon te tjere ne perpjekjet e tyre per te kuptuar dhe interpretuar standardet. BSNK gjithashtu publikoi nje dokument te veçante shoqerues. Ndryshime te Referencave te Kuadrin Konceptual ne Standartet e SNRF, i cili percakton amendimet ne standartet e ndikuara per te perditesuar referencat e Kuadrin Konceptual te rishikuar. Objektivi i tij eshte te mbeshtese kalimin ne Kuadrin Konceptual te rishikuar per shoqerite qe zhvillojne politika kontabel duke perdorur Kuadrin Konceptual kur asnje Standard i SNRF nuk zbatohet per nje transaksion te veçante. Per hartuesit qe zhvillojne politika kontabel bazuar ne Kuadrin Konceptual, ajo eshte efektive prej dates 1 janarit 2020. Ky standart nuk ka sjelle ndryshime ne keto pasqyra financiare.

#### - Ndryshimet ne SNRF 16 Lidhur me lehtesira e lidhura me qerane si pasoje e Covid 19

Me 28 maj 2020, BSNK publikoi ndryshime tek SNRF 16 Qera per lehtesira e lidhura me qerane si pasoje e Covid 19. Ndryshimet sigurojne lehtesim per qiramarresit nga zbatimi i udhezimeve te SNRF 16 per kontabilitetin e modifikimit te qirase per lehtesira qeraje qe vijne si pasoje e drejtperdrejte e pandemise Covid-19 . Si nje mjet praktik, nje qiramarres mund te zgjedhe te mos ndryshoje nese nje lehtesim qiraje ne lidhje me Covid-19 nga nje qiradhenes eshte nje modifikim i qirase. Nje qiramarres qe i ben keto zgjedhje llogarit per çdo ndryshim ne pagesat e qirase qe rezultojne nga lehtesimi i qirase ne lidhje me Covid-19 ne te njejten menyre qe do te llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nese ndryshimi nuk do te ishte nje modifikim i qirase. Ndryshimi zbatohet per periudhat vjetore te raportimit qe fillojne me ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet aplikimi me i hershem. Ky ndryshim nuk kishte asnje ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

### 2.5.2 Standarde dhe interpretime te reja qe nuk kane hyre ende ne fuqi dhe ende nuk jane zbatuar perpara dates efektive

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por qe nuk kane hyre ende ne fuqi, deri ne daten e deklarimit te pasqyrave financiare te Shoqerise, jane pasqyruar me poshte. Shoqeria synon te adoptoje keto standarde, nese jane te aplikueshme, kur ato te behen efektive.

#### - SNRF 17 Kontratat e sigurimit

Ne maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), nje standard i ri kontabel gjithepershires per kontratat e sigurimeve qe mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shenimet shpjeguese. Pasi te behet efektive, SNRF 17 do te zevendesojte SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) qe eshte nxjerre ne vitin 2005. SNRF 17 zbatohet per te gjitha llojet e kontratave te sigurimit (dmth., jete, jo-jete, sigurimi i drejtperdrejte dhe risigurimi), pavaresisht nga lloji i subjekteve qe i leshojne ato, si dhe per disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika te pjesemarrjes diskrecionare. Do te kete disa perjasthime nga objektivi. Objektivi i pergjithshem i SNRF 17 eshte te siguroje nje model kontabiliteti per kontratat e sigurimit qe te jete me i dobishem dhe i qendrueshem per siguruesit. Ne kontrast me kerkesat e SNRF 4, te cilat bazohen kryesisht ne politikat e meparshme te kontabilitetit, SNRF 17 ofron nje model gjithepershires per kontratat e sigurimeve, duke mbuluar te gjitha aspektet perkatese te kontabilitetit. SNRF 17 hyn ne fuqi per periudhat qe fillojne me ose pas 1 janar 2021 dhe zbatimi i tij kerkon paraqitjen e vlerave krahasuese te periudhave te meparshme. Aplikimi i me hershem eshte i lejueshem me kusht qe Shoqeria te aplikojte SNRF 9 dhe SNRF 15 me ose perpara dates se aplikimit te SNRF 17. Ky standard nuk eshte i aplikueshem per Shoqerine.

## 2. Bazat e Pergatitjes se Pasqyrave (vazhdim)

### 2.5.2 Standarde te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

- **Ndryshimet ne SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesemarrja e tij ose siper marrja e perbashket**

Ndryshimet adresojne konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 per trajtimin e humbjes se kontrollit mbi nje filial qe shitet ose kontribuohet tek nje pjesemarrje ose siper marrje e perbashket. Ndryshimet sqarojne se fitimi ose humbja qe rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve qe perbejne nje biznes, sic percaktohet ne SNRF 3, nga investitori tek pjesemarrja e tij ose siper marrja e perbashket, njihet plotesisht. Çdo fitim ose humbje qe rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve qe nuk perbejne nje biznes, njihet vetem ne masen e interesave te investitoreve te palidhur ne pjesemarrjen ose siper marrjen e perbashket. BSNK ka shtyre daten efektive te ketyre ndryshimeve per nje kohe te pacaktuar, por nje njesi ekonomike qe i aplikon ndryshimet me heret duhet t'i zbatoje ato ne menyre prospective. Drejtimi ka vleresuar se adoptimi i ketij ndryshimi nuk do te kete ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- **Ndryshimet ne SNK 1: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata**

Ne janar 2020, BSNK leshoi ndryshime ne paragrafet 69 deri 76 te SNK 1 per te specifikuar kerkesat per klasifikimin e detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Ndryshimet sqarojne:

- Çfare nenkuptohet me te drejten per te shtyre zgjidhjen detyrimit
- Se e drejta per shtyrje duhet te ekzistojte ne fund te periudhes se raportimit
- Klasifikimi nuk preket nga gjasat qe nje njesi ekonomike te ushtroje te drejten e saj te shtyrjes
- Kjo vetem nese nje instrument derivativ i konvertueshem ne detyrim eshte vete nje instrument i kapitali, kushtet e nje detyrimi nuk do te ndikojne ne klasifikimin e tij

Ndryshimet jane efektive per periudhat vjetore te raportimit qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet te zbatohen ne menyre retrospektive. Drejtimi ka vleresuar se adoptimi i ketij ndryshimi nuk do te kete ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- **Ndryshime te SNRF 3 Reference e Kornizes Konceptuale**

Ne maj te vitit 2020, BSNK publikoi ndryshime ne SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Reference ne Kuadrin Konceptual. Ndryshimet kane per qellim te zevendesojne referencen ne Kornizen per Pergatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare, te leshuar ne 1989, me nje reference ne Kornizen Konceptuale per Raportimin Financiar te leshuar ne mars 2018 pa ndryshuar ndjeshem kerkesat e saj. Bordi gjithashtu shtoi nje perjashtim ne parimin e njohjes se SNRF 3 per te shmangur çeshtjen e fitimeve ose humbjeve te mundshme te 'dites 2' qe lindin per pasivet dhe pasivet e kushtezuara qe do te ishin brenda fushes se SNK 37 ose KIRFN 21 Detyrime, nese ndodhin veçmas. Ne te njejten kohe, Bordi vendosi te sqaroje udhezimet ekzistuese ne SNRF 3 per aktivet e kushtezuara qe nuk do te ndikohen duke zevendesuar referencen ne Kuadrin per Pergatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare. Ndryshimet jane efektive per periudhat vjetore te raportimit qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022 dhe zbatohen ne menyre prospective.

- **Ndryshime te SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale: Arketime perpara perdorimit te synuar**

Ne Maj te vitit 2020, BSNK publikoi Aktivet Afatgjata Materiale - Arketime para perdorimit te synuar, i cili ndalon njesite ekonomike te zbresin nga kostoja e nje e aktiveve afatgjata materiale, çdo te ardhur nga shitja e produkteve te prodhuara ndersa e sjellin ate aktiv ne vendin dhe gjendjen e nevojshme qe asetit te jete i afte te veproje ne menyren e parashikuar nga Drejtimi. Ne vend te kesaj, nje njesi ekonomike i njeh te ardhurat nga shitja e produkteve te tille dhe kostot e prodhimit te ketyre produkteve, ne fitim ose humbje. Ndryshimi eshte efektiv per periudhat vjetore te raportimit qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2022 dhe duhet te zbatohet ne menyre retrospektive per produktet e aktiveve afatgjata materiale te vendosura ne dispozicion per perdorim ne ose pas fillimit te periudhes me te hershme te paraqitur kur njesia ekonomike zbaton per here te pare ndryshimin. Ndryshimet nuk pritet te kene nje ndikim material per Shoqerine

## 2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave (vazhdim)

### 2.5.2 Standarde te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

#### - Ndryshime te SNK 37 Kontrata te veshtira - Kostoja per permbushjen e kontrates

Ne maj te vitit 2020, BSNK publikoi ndryshime ne SNK 37 per te specifikuar se cilat kosto duhet te perfshije nje njesi ekonomike kur vlereson nese nje kontrate eshte e veshtire ose qe shkakton humbje. Ndryshimet zbatojne nje "qasje te lidhur drejtperdrejt me koston". Kostot qe lidhen drejtperdrejt me nje kontrate per te siguruar mallra ose sherbime perfshijne si koston rritese ashtu edhe nje alokim te kostove qe lidhen drejtperdrejt me aktivitetet e kontrates. Kostot e pergjithshme dhe administrative nuk kane te bejne drejtperdrejt me nje kontrate dhe perjashtohen nese nuk i ngarkohen pales tjetere ne menyre te qarte sipas kontrates. Ndryshimet jane efektive per periudhat raportuese vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2022. Shoqeria do t'i zbatoje keto ndryshime ne kontratat per te cilat ende nuk ka permbushur te gjitha detyrimet e saj ne fillim te periudhes raportuese vjetore ne te cilen aplikon per here te pare ndryshimet.

#### - Permiresime Vjetore 2018-2020

### SNRF 1 Adoptimi Fillestar i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar - Filiali si aplikues per here te pare

Ndryshimi lejon nje filial qe zgjedh te zbatoje paragrafin D16 (a) te SNRF 1 per te matur ndryshimet kumulative te perkthimit duke perdorur shumat e raportuara nga shoqeria meme, bazuar ne daten e tranzicionit te shoqerise meme ne SNRF. Ky ndryshim zbatohet gjithashtu per nje ndermarrje te lidhur ose te perbashket qe zgjedh te zbatoje paragrafin D16 (a) te SNRF 1. Ndryshimi eshte efektiv per periudhat raportuese vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janarit 2022, duke lejuar aplikimin e me hershem. Ndryshimet nuk kane ndikim tek Shoqeria.

### SNRF 9 Instrumentet Financiar - Tarifa ne "10 perqind" test per ç'njohjen e detyrimeve financiare

Ndryshimi sqaron tarifat qe nje njesi ekonomike perfshin kur vlereson nese kushtet e nje detyrimi te ri financiar ose te modifikuar jane thelbesisht te ndryshme nga kushtet e detyrimit origjinal financiar. Keto tarifa perfshijne vetem ato te paguara ose te marra ndermjet huamarresit dhe huadhenesit, perfshire tarifat e paguara ose te marra nga huamarresi ose huadhenesi. Nje njesi ekonomike zbaton ndryshimin ne detyrimet financiare qe modifikohen ose shkembhen ne ose pas fillimit te periudhes raportuese vjetore ne te cilen njesia ekonomike zbaton per here te pare ndryshimin. Ndryshimi eshte efektiv per periudhat vjetore te raportimit qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022, duke lejuar aplikimin e me hershem. Shoqeria do te zbatoje ndryshimet ne detyrimet financiare qe modifikohen ose shkembhen ne ose pas fillimit te periudhes raportuese vjetore ne te cilen njesia ekonomike zbaton per here te pare ndryshimin. Ndryshimet nuk pritet te kene nje ndikim material per Shoqerine.

### SNK 41 Bujqesia - Taksimi ne matjen e vleres se drejte

Ndryshimi heq kerkesen ne paragrafin 22 te SNK 41 qe njesite ekonomike perjashtojne flukset e parave per tatimin kur matni vleren e drejte te aktiveve brenda objektit te SNK 41. Nje njesi ekonomike zbaton ndryshimin ne menyre prospective per matjet e vleres se drejte ne ose pas fillimit te periudhes se pare vjetore te raportimit qe fillon me ose pas 1 janarit 2022, duke lejuar aplikimin e me hershem. Ndryshimet nuk pritet te kene nje ndikim material tek Shoqeria.

Shoqeria ka zgjedhur te mos i implementoje keto standarde, rishikime dhe interpretime perpara datave efektive te tyre. Shoqeria parashikon qe adoptimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne periudhen e aplikimit fillestar.

### 3. Gjykime dhe Vleresime të Rëndësishme Kontabile

Ne aplikimin e politikave kontabel të Shoqërisë, që përshkruhen në Shenimin nr 4, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, cmuarje, dhe supozime për vlerën kontabel të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktore të tjera që konsiderohen të rëndësishme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në cmuarjet kontabel do të njihen në periudhën në të cilën cmuarja është rishikuar nëq rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhën e ardhshme nëq rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

#### *Pasiguria në gjykime*

##### *Zhvleresimi i aktiveve jofinanciare*

Humbjet nga zhvleresimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabel e aktiveve ose e njësive gjeneruese të parase tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njësi gjeneruese e parase dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parase.

##### *Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme*

Drejtimi rishikon rregullisht jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlereson nëse jeta e përcaktuar si e dobishme e aktiveve, përfaqëson dobishmerinë e pritur të aktiveve. Vlerat kontabel e këtyre aktiveve analizohet në Shenimin 5, 6, dhe Shenimin 7. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjeterimit teknologjik dhe faktoreve të tjera.

##### *Zhvleresimi i aktiveve financiare*

##### *Zhvleresimi i llogarive të arketueshme dhe të tjera të arketueshme*

Shoqëria llogarit zhvleresimin për llogaritë e arketueshme dhe për llogaritë e tjera të arketueshme bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paafësia e klienteve për të bërë pagesat e kërkuara. Vleresimi është bazuar në vjeterimin (aging) e gjendjes së llogarive të arketueshme dhe përvojën historike të shlyerjes, kreditin e konsumatorëve dhe ndryshimeve në aspektin e pagesave të konsumatorëve gjatë vleresimit të humbjes nga zhvleresimi për llogaritë e dyshimta. Keto përfshijnë supozime mbi sjelljen e konsumatorëve dhe mbledhjen e mjeteve monetare të ardhshme që rezultojnë prej saj. Nëse gjendja financiare e klienteve do të përkeqësohet, zhvleresimi aktual i llogarive të arketueshme ekzistuese mund të jetë më i lartë se sa pritjet dhe mund të tejkalojë nivelin e humbjeve nga zhvleresimi të njohura deri tani.

##### *Inventaret*

Inventari fillimisht rregjistrohet me kosto, që përbehet nga cmimi i blerjes duke shtuar dhe kostot e drejtperdrejta si transport dhe parking, akcize, kosto e analizës së cilësive të mallit të importit dhe taksat e agjensisë doganore.

Inventari me pas paraqitet me vlerën me të ulët mes koston dhe vlerën neto të realizueshme. Kur përcakton vlerën neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh provat me objektive / të dhënat në dispozicion të marra gjatë kryerjes së vlerësimeve.

Vlera neto e realizueshme është e vlerësuar me cmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus shpenzimet e nevojshme për të bërë produktin gati për t'u shitur.

#### 4. Permbledhje e Politikave të Rendesishme Kontabile

##### 4.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhe të huaj janë të konvertuara në leke dhe regjistrohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët monetarë dhe zera të tjera jo monetarë në monedhe të huaj rivelesohen në leke me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës raportuese. Diferencat e këmbimit valutës janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të Shoqërisë. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zerave të pozicionit financiar të shprehur në monedhe të huaj paraqiten si vijon (në Leke):

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	107.82

##### 4.2 Aktivët afatgjatë materiale dhe jo-materiale

Aktivët afatgjatë materialë dhe jo-materiale janë deklaruar me vlerën kontabel neto, pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe/ose humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kjo kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen direkt me blerjen e aktiveve. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e lendeve të para dhe punës, dhe çdo kosto tjetër që lidhet direkt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune, koston e montimit dhe heqjes së mjeteve dhe rikonstruksionit i vendit ku ato janë vendosur dhe koston e kapitalizuar të huamarrjes. Koston shtesë janë përfshirë në vlerën e aktivitetit ose njihet si një aktiv i vecantë, sipas nevojës, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me artikullin do të hyjnë në Shoqëri dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera, ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë si më poshtë:

	Norma e amortizimit %	Norma e amortizimit %	Baza e llogaritjes
	2020	2019	
<b>Aktivët afatgjatë materiale</b>			
Ndertesa	5%	5%	Metoda lineare
Makinëri dhe pajisje	7 -20%	7 -20%	Vlera kontabel neto
Bombula	5 -11%	5-11%	Vlera kontabel neto
<b>Aktivët afatgjatë jo-materiale</b>			
Rregjistrim markash	5%	5%	Metoda lineare

Vlerat e mbetura dhe jeta e përdorimit të aktiveve janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e përshatshme, në datën përkatëse të pozicionit financiar. Vlera kontabel e një aktivi është zhvlerësuar menjëherë në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera kontabel e aktivitetit është më e madhe sesa shuma që vlerësohet të rikupërohet. Fitimet dhe humbjet nga shitjet e aktiveve, janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën e aktivitetit. Keto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### 4. Permbledhje e Politikave të Rendesishme Kontabile (vazhdim)

##### 4.3 Instrumentet financiare

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arketueshme dhe depozitat monetare në datën kur ato janë krijuar. Aktivet Financiare klasifikohen në njohjen fillestarë dhe maten me vlerë me kostë të amortizueshme, me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse (OCI), dhe me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria c'regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria është njohur si një aktiv apo detyrim i vecantë. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumën dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e kërkesa të arketueshme dhe të tjera të arketueshme, mjetet monetare, dhe furnitoret dhe detyrimet e tjera.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë paratë e mbajtura në bankat lokale në monedhën vendase dhe të huaja dhe paraqiten me kostë

##### *Llogaritë e kërkesa të arketueshme dhe Llogaritë e kërkesa të tjera të arketueshme*

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe me pas maten me kostën e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjionet për zhvlerësim. Një provigjion për zhvlerësimin i llogaritë të arketueshmeve krijohet kur ka evidence objektive se Shoqëria nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjitha shumën sipas kushteve fillestare të llogaritë të arketueshmeve.

Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesa ose vështirësi në pagesa konsiderohen si tregues të llogaritë të arketueshmeve është zhvlerësuar. Shuma e provigjionit është diferenca midis vlerës kontabel të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Aktivet me maturim të shkurtër nuk janë skontuar. Vlera kontabel e aktivitetit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogaritë zbritje, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kur një llogaritë e arketueshme është e pambledhshme, ajo është zbritur kundrejt llogaritë se zhvlerësimit për llogaritë të arketueshme. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura me parë janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

##### *Furnitoret dhe detyrimet e tjera*

Furnitoret dhe detyrimet e tjera janë pasqyruar fillimisht me vlerë të drejtë dhe me pas me kostën e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Huate dhe kredite*

Huate dhe kredite maten fillimisht me vlerën e drejtë, neto për kostot e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me kostën e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, ndërkohe që shpenzimet e interesit njihen me normën efektive të interesit. Metoda e interesit efektiv është një metode e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e regjistrimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat e ardhshme monetare të vlerësuar gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, gjatë një periudhe më të shkurtër.



#### 4. Permbledhje e Politikave të Rendesishme Kontabile (vazhdim)

##### 4.4 Zhvleresimet

###### *Aktivet financiare*

Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, vleresohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka nje evidence objektive se ai eshte zhvleresuar. Shoqeria njezh nje zhvleresim per humbjet e pritshme te kredise (ECL) per te gjitha instrumentet e borxhit qe nuk mbahen me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen ne diferencen ndermjet flukseve monetare kontraktuale qe duhet te paguhen ne perputhje me kontraten dhe te gjitha flukse monetare qe Shoqeria pret te marre, te skontuara me nje peraftrim te normes fillestare te interesit efektiv. Flukset monetare pritet te perfshijne flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit te mbajtur ose te ardhura te tjera qe jane pjese perberese e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diferenca midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve monetare te vleresuara te ardhshme te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivitetit. Humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen ne nje llogari zhvleresimi perkundrejt llogarive te arketueshme. Interesat mbi aktivet e zhvleresuara vazhdojne te njihen nepermjet skontimeve te pandryshueshme. Kur nje ngjarje pasuese ndikon ne uljen e shumes se zhvleresimit, renia ne humbjen nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires. Per te llogarite e arketueshmet tregtare, Shoqeria zbaton nje qasje te thjeshtuar ne llogaritjen e ECLs. Si rrjedhoje, Shoqeria nuk ndjek ndryshimet ne rrezikun e kredise, por ne vend te kesaj njezh nje humbje nga zhvleresimi te bazuar ne jetgjatesine e ECL-ve ne cdo date raportimi. Shoqeria ka krijuar nje matrice provizionesh qe bazohet ne pervojat e saj historike te humbjeve nga kreditimi, te pershtatur per faktoret e ardhshem qe jane specifike per debitoret dhe mjedisin ekonomik.

###### *Aktivet jo-financiare*

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise rishikohet ne daten e raportimit per te percaktuar nese ka evidence per zhvleresim. Nese ka evidence te tilla, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme eshte me e madhja midis vleres se drejte minus koston per shitje dhe vleres ne perdorim. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme te mjeteve monetare jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivitetin per te cilat vleresimet e flukseve monetare te ardhshme nuk jane rregulluar.

Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires (ne fitim ose humbje).

##### 4.5 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne te ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e sherbimeve.

Te ardhurat maten duke ju referuar vleres se drejte te shumes se marre ose te arketueshme nga Shoqeria per mallrat e shitura dhe te sherbimeve te ofruara, duke perjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.

Shoqeria zbaton kriteret e njohjes se te ardhurave te percaktuara me poshte per secilin komponent te identifikueshem te transaksionit te shitjes per te reflektuar thelbin e transaksionit. Shuma e marre nga keto transaksione eshte ndare ne komponentin e vecante te identifikueshem duke marre parasysh vleren relative te drejtepercdo komponent.

Te ardhurat njihen kur shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme, mbledhja eshte e mundshme, shpenzimet e bera ose qe do te behen te mund te maten me besueshmeri, dhe kur kriteret per secilin nga aktivitetet e ndryshme te Shoqerise jane permbushur. Keto kriteret njohje sipas aktiviteve specifike jane te bazuara ne mallrat apo zgjidhjet e ofruara per konsumatorin dhe kushtet e kontrates ne cdo rast, dhe jane pershkruar me poshte:

#### 4. Permbledhje e Politikave të Rendesishme Kontabile (vazhdim)

##### 4.5 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

###### *Shitja e mallrave me shumice dhe pakice*

Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur produktet i janë shitur klienteve.

###### *Dhenia e shërbimeve*

Te ardhurat nga shitja e shërbimeve janë njohur në periudhën në të cilën janë kryer shërbimet.

###### *Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare*

Te ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet në valute të huaj.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, humbjet në valute të huaj, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nepërmjet fitimit ose humbjes, dhe humbjet e njohura nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutë raportohen në baza neto.

##### 4.6 Inventaret

Inventari paraqitet me vlerën me të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme përfaqëson minimumin e mëposhtme të shitjes për inventaret minus të gjitha kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

##### 4.7 Qirate

Percaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban terma qiraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes në datën e fillimit të saj, nëse përmbushja e marrëveshjes ka të bëjë me përdorimin e aktivitetit, ose aktiveve specifike ose marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit të aktivitetit, edhe pse e drejta nuk është shprehur qartë në një marrëveshje.

###### *Shoqëria si qiramarrës*

Qerate kontabilizohen sipas modelit "të së drejtës së përdorimit". Qirate të cilat transferojnë tek shoqëria në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që shoqërojnë pronësinë e aktivitetit të marrë me qira, kapitalizohen në momentin e fillimit të qirës me vlerën e drejtë. Pagesat e qirës shpërndahen mes detyrimeve financiare dhe zvogelimit të detyrimit të qirës, në mënyrë që të sigurohet një normë interesi e qëndrueshme në balancën e mbetur të detyrimit. Detyrimet financiare njihen si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Një aktiv i marrë me qira financiare amortizohet përgjate jetës së dobishme të tij. Megjithatë, nëse në fund të periudhës së qirës, nuk ekziston një mundësi e arsyeshme që shoqëria të fitojë pronësinë mbi aktivin, aktiviteti amortizohet përgjate periudhës me të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar dhe kohezgjatjes së qirës.

Pagesat për qira afatshkurtra me pak se 12 muaj njihen si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në baze lineare gjatë afatit të qirës. Në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe qirate e aseteve me vlerë të ulët prej 5,000 Euro ose më pak. Asetet me vlerë të ulët përfshijnë kompjutera laptop, mobiljeve për zyrë, telefona dhe pajisje të tjera me vlerë të ulët por përjashtojnë automjetet sepse një automjet i ri zakonisht nuk ka vlerë të ulët.

##### 4.8 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me Legjislacionin Shqiptar mbi Tatimin mbi Fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje për sa kohë që lidhet me zera të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose substancialisht në fuqi në datën e raportimit, dhe cdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur me 15% (2019: 15%) të fitimit të tatueshem.

#### **4. Permbledhje e Politikave të Rendesishme Kontabile (vazhdim)**

##### **4.8 Tatim Fitimi (vazhdim)**

Tatimi i shtyre është njohur duke përdorur metodën e bilancit kontabel, nga diferencat e perkohshme ndërmjet vlerës kontabel të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyre është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të perkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyre njihet për sa kohë është e mundur që fitimi i tatueshem i ardhshëm të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoret ndryshim i perkohshëm. Aktivitetet e tatimit të shtyre (nese ka) janë rishikuar në secilën datë të raportimit dhe janë reduktuar deri në masën ku nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

##### **4.9 Përfitimet pas-daljes në pension dhe planet e pensione**

Shoqëria kryen vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që ofrojnë punonjësve përfitime pas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e shoqërisë ndaj planit të pensioneve janë ngarkuar në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

##### **4.10 Kapitali**

Kapitali aksioner përbehet prej mjeteve monetare të kontribuar nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksioner mbahet në shumën e konvertuar leke të monedhës së huaj të marre, duke përdorur kursin e këmimit në datën e transaksionit.

##### **4.11 Provigjonet**

Një provigjon njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të mëparshme dhe është e mundur që të ketë një dalje të burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provigjonet rishikohen në çdo datë të pozicionit financiar dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin me të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parës është material, shuma e provigjonit është vlera aktuale e shpenzimeve të pritshme të nevojshme për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

##### **4.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e një dalje të burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike është shumë e ulët. Një aktiv i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por është pasqyruar në shenimet shpjeguese kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes së kushtëzuar është njohur si provigjon nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmohen dhe se mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes në datën e pozicionit financiar.

##### **4.13 Transaksionet e paleve të lidhura**

Palet e lidhura janë ato ku njëra nga palet është e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palës tjetër.

##### **4.14 Ngjarje pas periudhës së raportimit**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e shoqërisë në datën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë pasqyruar në shënime kur janë materiale.

##### **4.15 Shifrat krahasuese**

Shpenzimet e qerases së magazinimit janë riklasifikuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë nga kosto e shitjeve tek të tjera shpenzime të përgjithshme dhe administrative për të dhënë një paraqitje më të drejtë të këtij zeri. Ky ndryshim në politikën kontabel është aplikuar në mënyrë retrospektive.

5. Aktive afatgjata te trupezuara

	Toka	Ndertesa	Makineri, impiante dhe pajisje	Bombula	Asete me të drejtë përdorimi IFRS 16	Totali
<i>Kosto</i>						
Me 1 janar 2019	184,334	122,274	203,133	82,267	-	592,008
Shtesa	-	-	4,013	4,511	2,866	8,524
Pakesime	-	-	-1,064	-82		-1,146
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>184,334</b>	<b>122,274</b>	<b>206,082</b>	<b>86,696</b>	<b>2,866</b>	<b>602,252</b>
Shtesa	-	-	13,007	126	242	13,375
Pakesime	-	-	-4,920	-403		-5,323
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>184,334</b>	<b>122,274</b>	<b>214,169</b>	<b>86,419</b>	<b>3,108</b>	<b>607,196</b>
<i>Amortizim i akumuluar</i>						
Me 1 janar 2019	-	-39,331	-93,034	-27,212	-	-159,577
Shpenzimi per vitin	-	-4,042	-12,970	-5,378		-22,390
Pakesime	-		493	16		509
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>-43,373</b>	<b>-105,513</b>	<b>-32,574</b>	<b>-</b>	<b>-181,458</b>
Shpenzimi per vitin	-	-3,844	-12,147	-4,972		-20,963
Pakesime	-		1,370	262		1,632
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>-47,217</b>	<b>-116,288</b>	<b>-37,284</b>	<b>-</b>	<b>-200,789</b>
<i>Vlera e mbartur</i>						
Me 1 janar 2019	184,334	82,943	110,099	55,055		432,431
Me 31 dhjetor 2019	184,334	78,901	100,571	54,122	2,866	420,794
Me 31 dhjetor 2020	184,334	75,057	97,881	49,135	3,108	409,515

## 6. Aktive afatgjata te patrupezuara

	<u>Totali</u>
<b>Kosto</b>	
Me 1 janar 2019	9,135
Shtesa	-
Me 31 dhjetor 2019	<u>9,135</u>
Shtesa	-
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>9,135</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>	
Me 1 janar 2019	-694
Shpenzimi per vitin	-218
Me 31 dhjetor 2019	<u>-912</u>
Shpenzimi per vitin	-212
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>-1,124</b>
<b>Vlera e mbartur</b>	
Me 1 janar 2019	<u>8,441</u>
Me 31 dhjetor 2019	<u>8,223</u>
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>8,011</b>

Shpenzimet e amortizimit jane shperndare si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Kosto e shitjeve	10,375	11,078
Shpenzimet e shitjes dhe shperndarjes	9,528	10,174
Shpenzimet administrative	1,270	1,357
<b>Totali</b>	<b>21,173</b>	<b>22,609</b>

## 7. Inventaret

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Mallrat	9,212	12,057
Materiale te para	11,314	11,533
<b>Totali</b>	<b>20,526</b>	<b>23,590</b>

## 8. Te arketueshme tregtare dhe te tjera

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Te arketueshme nga palet e treta	105,386	105,118
Te arketueshme nga palet e lidhura (shenimi 22)	31,620	34,876
Zbritje per zhvleresimine llogarive te arketueshme	(32,604)	(44,554)
	<u>104,402</u>	<u>95,720</u>

Levizja nezhvleresiminelllogarive te arketueshme paraqitet si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Teprica e zhvleresimit me 1 janar	44,554	37,149
	(19,361)	
Zhvleresimi i vitit (shenimi 17)	7,411	7,405
<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>32,604</b>	<b>44,554</b>

#### 9. Parapagime edhe aktive te tjera

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Aktive te tjera afatshkurter	(5,174)	8,693
Parapagime	(0)	(0)
TVSH e arketueshme	(4,391)	(2,747)
<b>Totali</b>	<b><u>-9,565</u></b>	<b><u>5,946</u></b>

#### 10. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Mjete monetare ne banka	40,876	15,996
Mjete monetare ne arke	240	1,924
<b>Totali</b>	<b><u>41,116</u></b>	<b><u>17,920</u></b>

#### 11. Kapitali

Me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, kapitali aksionar i nenshkruar eshte i perbere nga nje aksion me vlere nominale prej 700,272 mije Leke.

Aksionari i vetem i Shoqerise eshte Messer Tehnogas AD dhe kapitali aksionar me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, ishte si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Kapital i regjistruar	700,272	700,272
Kapital i paregjistruar	6,500	6,500
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>	<b><u>706,772</u></b>	<b><u>706,772</u></b>

Rezerva prej 6,208 mije Leke (2019: 6,208 mije Leke) perfaqeson rezerven e krijuar me Vendim te Aksionarit me24 shkurt 2012.

#### 12. Te pagueshme tregtare dhe te tjera

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Detyrime ndaj paleve te lidhura (shenimi 22)	128,389	133,661
Llogarite e pagueshme tregtare	17,228	12,714
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b><u>145,617</u></b>	<b><u>146,375</u></b>
Taksatepagueshme	1108	885
	181	10
Shpenzime te perlllogaritura	(3)	(128)
<b>Totali i detyrimeve jo-financiare</b>	<b><u>1,286</u></b>	<b><u>767</u></b>
<b>Totali</b>	<b><u>146,901</u></b>	<b><u>147,142</u></b>

#### 13. Parapagime te marra

Parapagimet perfaqesojne garanci te vendosura nga konsumatorët per marrjen ne dorezim te bombulave te gazit, ne vleren e 7,352 mije Leke me 31 dhjetor 2020 (2019: 7,332 mije Leke).

#### 14. Fitimi bruto

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shitje paleve te treta	388,934	349,454
Shitje paleve te lidhura (Shenimi 22)	2,034	1,429
<b>Shitje (i)</b>	<b>390,968</b>	<b>350,883</b>
Kosto e shitjeve me shumice	(194,144)	(177,101)
Kosto e shitjeve me bombula	(124,125)	(113,229)
<b>Kosto e shitjeve</b>	<b>(318,269)</b>	<b>(290,330)</b>
<b>Fitimi bruto</b>	<b><u>72,699</u></b>	<b><u>60,553</u></b>

(g) Shitjet per periudhat qe perfundojne me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jane te detajuara si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shitje te mallrave:	390,968	350,883
<i>Me shumice</i>	130,503	130,428
<i>Gazra mjekesore me shumice</i>	102,371	99,178
<i>Gazra teknike</i>	87,257	82,593
<i>Gazra special</i>	23,294	15,633
<i>Gazra mjekesore</i>	41,625	15,520
<i>Materiale</i>	5,918	7,531
Shitje te sherbimeve	-	-
Zbritje per klientet	-	-
<b>Totali shitjeve</b>	<b><u>390,968</u></b>	<b><u>350,883</u></b>

Sherbimet dhe produktet shiten pergjithesisht ne baze te porosive te blerjes ose kontratave qe perfshijne çmime fikse per njesi, por qe zakonisht nuk perfshijne te drejta kthimi ose detyrime te tjera thelbesore pas dorezimit. Kontratat e sherbimeve zakonisht drejtohen nga kerkesa me baze ditore. Shitjet, pergjithesisht faturohen pas perfundimit te kryerjes se sherbimit. Kushtet e pageses ndryshojne sipas llojit, vendndodhjes, produkteve ose sherbimeve te ofruara nga klienti. Afati midis faturimit dhe momentit te pageses nuk eshte i rendesishem.

#### 15. Te ardhura te tjera

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shitja e aktiveve dhe sherbimeve te tjera	23,978	17,753
Fitim nga shitje e asetave	1,734	51
Te ardhura te tjera	1,223	26
<b>Totali</b>	<b><u>26,935</u></b>	<b><u>17,830</u></b>

#### 16. Shpenzime te shitjes dhe shperndarjes

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shitje	29,601	26,283
Shperndarje	24,782	22,005
Paketim	14,455	12,836
<b>Totali</b>	<b><u>68,838</u></b>	<b><u>61,124</u></b>

Shpenzimet e personelit detajohen si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Paga dhe shperblime	29,916	29,878
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,011	3,945
<b>Totali</b>	<b><u>33,927</u></b>	<b><u>33,823</u></b>

Me 31 dhjetor 2020, Shoqeria kishte 22 punonjes (2019: 23 punonjes). Shpenzimet e personelit jane ndare sipas funksionit si me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Kosto e shitjeve	15,606	15,559
Shpenzime te shitjes dhe shperndarjes	13,910	13,868
Shpenzime administrative	4,411	4,396
<b>Totali</b>	<b><u>33,927</u></b>	<b><u>33,823</u></b>

#### 17. Shpenzime administrative

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Ligjore dhe konsulence	2,165	2,283
Shpenzimet e personelit	4,411	4,397
Udhetimi dhe transporti	2,743	5,623
Mirembajtja dhe riparimi	1,180	662
Amortizim	1,270	1,357
Sigurime	2,363	2,199
Tatimet dhe doganat	792	752
Qira	1,485	1,390
Shpenzime te tjera te zyres	2,434	2,063
Perfaqesimi dhe donacionet	-	1,145
Telefoni dhe komunikimi	90	105
Siguria	1,800	1,800
Gjobat	6,759	503
<b>Totali</b>	<b><u>27,492</u></b>	<b><u>24,278</u></b>



## 18. Tatimi mbi fitimin

	2020	2019
Tatim i vitit	(3,456)	-
Perfitimi/(shpenzimi) i tatimit të shtyre mbi fitimin	269	954
<b>Totali</b>	<b>(3,725)</b>	<b>954</b>

Shoqëria percakton tatimin në fund të vitit sipas legjislacionit tatimor shqiptar. Në vitin 2020 norma e tatimit ishte 15% (2019: 15%) e fitimit të tatueshem. Tatimi i shtyre është llogaritur duke u bazuar në normën e miratuar tatimore prej 15% (2019: 15%).

Me poshtë është një barazim i tatimit, llogaritur me normën perkatese me shpenzimin e tatimit:

	Norma e Tatimit	2020	Norma e Tatimit	2019
Humbje para tatimit		2,052		(6,055)
Llogaritja me normën 15%	15%	308	15%	(908)
Shpenzime të panjohura për qellime tatimore	153%	3,148	-48%	2,905
Ndryshim në diferencat e perkohshme	13%	269	16%	(954)
Humbje tatimore të mbartura	0%	-	0%	-
Perdorimi i humbjeve të mbartura të panjohura me pare	0%	-	33%	(1,997)
	<b>181.57%</b>	<b>3,725</b>	<b>15.76%</b>	<b>(954)</b>

Humbjet fiskale të panjohura paraqesin humbjet e tatueshme të Shoqërisë mbartura nga e shkuarane periudhat e ardhshme. Periudha e mbartjes së humbjeve fiskale sipas ligjit në Shqipëri është tre vjet. Humbjet e mbartura tatimore më 31 dhjetor 2020, paszbatimit të normës tatimore janë detajuar me poshtë:

Humbjet tatimore të mbartura	Efekti I humbjes tatimore	Efekti perdorimit	Accumulated effect of tax losses
Viti 2020	-	(1,530)	0
Viti 2019		(1,997)	1,530
Viti 2018	-	(332)	3,527
Viti 2017	3,442	-	3,859
Viti 2016	-	(3,861)	417

Tatimi i shtyre në lidhje me humbjet e mbartura tatimore nuk është njohur, sepse nuk është e sigurtë se do të ketë fitime tatimore të ardhshme kundrejt të cilave Shoqëria mund të shfrytëzojë perfitimet prej tyre.

Levizjet e detyrimeve tatimore të shtyra janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	Levizjet	31 dhjetor 2019	Levizjet	31 dhjetor 2020
Aktive afatgjata të trupezuara	(5,984)	954	(5,030)	(269)	(5,299)
<b>Detyrime tatimore të shtyre</b>	<b>(5,984)</b>	<b>954</b>	<b>(5,030)</b>	<b>(269)</b>	<b>(5,299)</b>

## 19. Administrimi i rrezikut financiar

### (a) Hyrje dhe pamje e përgjithshme

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve nga përdorimi i instrumenteve të saj financiare:

- rreziku i kredise
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

#### *Kuadri i administrimit të rrezikut*

Bordi Drejtues dhe aksioneri i vetëm mban përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për administrimin e rrezikut. Bordi gjithashtu është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballë Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqëria, përmes standardeve dhe procedurave të administrimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi i Shoqërisë kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikën me të mira. Drejtimi i bazuar në keto analiza për përfitueshmëri, likuiditetin dhe koston e fondeve zbaton masat në lidhje me rreziqet e kredise, tregut dhe likuiditetit. Në këtë mënyrë Shoqëria i përgjigjet sfidave dhe mjedisit të tregut, duke ruajtur një pozitive të qëndrueshme të kapitalit dhe të likuiditetit. Veprimtaria aktuale e Shoqërisë, mbështetet nga kontributet e pronarit.

### (b) Rreziku i kredise

Rreziku i kredise është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një pale e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale që lindin kryesisht nga llogaritë e arketueshme të Shoqërisë. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron elemente të ekspozimit të rrezikut të kredise, të tilla si rreziku i humbjes së aftësisë paguese individuale dhe rreziqet e tjera të klienteve.

	2020	2019
Jo në vonese	37,255	38,069
Ne vonese deri në 30 dite	2,723	2,783
Ne vonese 31 deri në 60 dite	10,706	10,940
Ne vonese 61 deri në 90 dite	5,642	5,765
Ne vonese 91 deri në 120 dite	12,226	12,492
Ne vonese 121 deri në 180 dite	5,353	10,470
Ne vonese 181 deri në 270 dite	5,361	10,478
Ne voneseme shumë se 270 dite	57,738	48,998
<b>Te arketueshme tregtare, bruto</b>	<b>137,005</b>	<b>139,994</b>
Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme (Shënim 9)	-32,604	-44,554
<b>Shuma në fund të vitit</b>	<b>104,401</b>	<b>95,440</b>

Te arketueshment nga palet e lidhura përfshihen shumën prej 31,620 mijë Leke (2019: 34,876 mijë Leke), shumë kjo e vjetër mbi 365 dite. Drejtimi beson se do të jetë në gjendje të arketojë keto balanca dhe nuk e ka konsideruar atë si të zhvlerësuar.

#### *Llogaritë e arketueshme të zhvlerësuar*

Llogaritë e arketueshme për të cilat Shoqëria përcakton se nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumat e pashlyera sipas kushteve kontraktuale të marreveshjes (ve) janë të zhvlerësuar.

#### *Politika e çregjistrimit*

Shih Shënimin 4.3.

#### *Kolaterali*

Depozitat e garancise janë vendosur nga konsumatorët kur dorëzohen bombulat e gazit (shih shënimin 13).

## 19. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria do të hasë vështirësi në plotësimin e angazhimeve nga detyrimet e saj financiare.

#### Administrimit i rrezikut të likuiditetit

Pikepamja e Shoqërisë për administrimin e likuiditetit është për të siguruar, aq sa është e mundur, që ajo do të ketë gjithmonë likuiditet temjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur, në të dyja kushtet si ato të renda dhe normale, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikun e demtimit të reputacionit të Shoqërisë. Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara të detyrimeve financiare mbi bazën e maturitetit kontraktual ose flukseve të pritshme.

	Deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Me shumë se 1 vit	Totali
31 dhjetor 2020	81,504	64,112	-	145,616
31 dhjetor 2019	76,115	70,261	-	146,376
31 dhjetor 2018	83,979	81,107	-	165,086

Te pagueshmet tregtare ndaj paleve të lidhura në shumën prej 128,389 mijë Leke (2019: 133,661 mijë Leke) janë klasifikuar si detyrime afatshkurtra. Megjithatë, shlyerja e tyre mund të shtyhet bazuar në nevojat për likuiditet të nevojshëm për drejtimin.

### (d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimit të tregut, siç janë kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare që mban ai. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është për të administruar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Kjo është një formë e rrezikut që rrjedh nga ndryshimi i çmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhës është administruar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Shoqëria nuk ka pasur ndonjë mbrojtje si kontrate këmbimi 'forward' apo produkte derivative të integruara në kontrata me 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe aktivet financiare dhe detyrimet financiare në monedha të huaja janë si më poshtë:

31 dhjetor 2020	Vlera në Lek '000		
	Lek	Euro	Totali
<b>Aktivët</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	38,013	3,103	41,116
Te arketueshme tregtare e të tjera	85,593	51,412	137,005
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>123,606</b>	<b>54,515</b>	<b>178,121</b>
<b>Detyrimet</b>			
Te pagueshme tregtare e të tjera	-10,106	-135,510	-145,616
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>-10,106</b>	<b>-135,510</b>	<b>-145,616</b>
<b>Pozicioni i likuiditetit neto</b>	<b>113,500</b>	<b>-80,995</b>	<b>32,505</b>
			Vlera në Lek '000
31 dhjetor 2019	Lek	Euro	Totali
<b>Aktivët</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	16,758	1,162	17,920
Te arketueshme tregtare e të tjera	68,625	71,369	139,994
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>85,383</b>	<b>72,531</b>	<b>157,914</b>
<b>Detyrimet</b>			
Te pagueshme tregtare e të tjera	-9,966	-136,410	-146,376
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>-9,966</b>	<b>-136,410</b>	<b>-146,376</b>
<b>Pozicioni i likuiditetit neto</b>	<b>75,417</b>	<b>-63,879</b>	<b>11,538</b>

## 19. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (d). Rreziku i Tregut (vazhdim)

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut te normes se interesit*

Rreziku i normes se interesit eshte rreziku i humbjes nga luhatjet ne flukset e mjeteve monetare apo nga vlera e drejte e intrumenteve financiare per shkak te ndryshimit ne normat e interesit te tregut. Shoqeria nuk eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te normave te interesit sepse nuk ka intrumente financiare me interes.

## 20. Kushtezime dhe angazhime

### *Ligjore*

Ne rrjedhen normale te biznesit, Shoqeria haset me pretendimet ligjore dhe gjyqesore. Drejtimi i Shoqerise eshte i mendimit se asnje humbje materiale nuk do te shkaktohet nga pretendimet ligjore te pazgjidhura me 31 dhjetor 2020.

### *Detyrimet e mundshme*

Ne menyre qe te merret parasysh çdo rrezik i mundshem i humbjeve te lidhura me ndonje inspektim te ardhshem tatimor dhe vleresimin e detyrimeve tatimore nga organet tatimore, Shoqeria vlereson detyrimet e mundshme tatimore dhe probabilitetin qe detyrimet e tilla te lindin.

Drejtimi beson se nuk eshte aq e mundur qe te mira ekonomike do te kerkohen per shlyerjen e detyrimeve te mundshme ne lidhje me tatimin. Prandaj asnje provizion shtese per rreziqe te tilla tatimore nuk eshte njohur ne keto pasqyra financiare.

Informacione te reja mund te jene ne dispozicion qe te shkaktojne ndryshimin e gjykimeve te Shoqerise ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshimet e tilla ndikojne shpenzimet e tatimit ne periudhen qe behen.

## 21. Transaksionet me pale te lidhura

Shoqeria memeperfundimtare eshteMesser Group GmbH. Shoqeria hyn ne veprime me Memen, me shoqerite e lidhura, dhe me drejtuesit ekzekutive.

<i>Balancat dhe veprimet me palet e lidhura</i>	<u>2020</u>	<u>2019</u>
<i>Te arketueshme nga palet e lidhura (shenimi 9):</i>		
Messer GTM, Kosovo	31,367	30,878
Messer Tehnogas Vardar	-	13
Messer Cutting System GmbH.	253	253
Messer Tehnogas AD	-	3,020
Messer Bulgaria	-	63
Messer Tehnogas AD Niksic	-	650
	<u>31,620</u>	<u>34,877</u>
<i>Detyrime ndaj paleve te lidhura(shenimi 13):</i>		
Messer Tehnogas AD	105,760	109,169
Messer Tehnogas Vardar	19,669	20,605
Messer Austria	132	186
Messer Tatrugas s.p.o.l	-	2,406
Messer Tehnogas AD Niksic	-	700
Gaspac GmbH	401	395
Messer Bulgaria EOOD	-	-
Messer Group GmbH	28	91
Messer Polska	-	109
Messer Hungarogaz KFT	1907	-
Messer Croatia Plin D.O.O	492	-
	<u>128,389</u>	<u>133,661</u>

<i>Shitje (Shenimi 14)</i>	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Messer GTM, Kosovo	55	236
Messer Tehnogas AD	-	-
Messer Group gmbh	-	1,193
Messer Tehnoplín	64	-
Messer Tehnogas AD Niksic	1426	-
Messer Tehnogas Vardar	489	-
	<u>2,034</u>	<u>1,429</u>

<i>Shpenzime</i>	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Kompensimet e drejtimit	-	3,534
Kosto e shitjeve	185,465	157,554
	<u>185,465</u>	<u>161,088</u>

## 22. Ngjarjet pas dates se raportimit

Nuk ka ngjarje te rendesishme pas dates se raportimitqe mund te kerkojne korrigjime apo shenime sqaruesene pasqyrat financiare.